



Datë: 15.04.2025
Numër protokolli: 2496/2025

A.nr.375/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari—anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.375/2025 të datës 27.02.2025 të parashtruar nga ankuesja K.U. të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Agim Rexhaj nga Ferizaji, kundër organit të punësimit Komunës së Shtimes, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.375/2025 e datës 27.02.2025 e parashtruar nga ankuesja K.U.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile K.U. (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 24.02.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është pranuar me datë 27.02.2025 dhe është regjistruan nën shenjën 1302/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit të Kryetarit të Komunës së Shtimes me numër 02Nr.1180 të datës 13.11.2024 dhe përgjigjes në ankesë të datës 14.02.2025 të Komunës së Shtimes në lidhje me ngarkimin me funksione shtesë pa kompensim dhe pa bazë ligjore kërkon ti aprovohet ankesa të anulohet vendimi i Kryetarit të Komunës së Shtimes me numër 02Nr.1180 i datës 13.11.2024 dhe të obligohet komuna që ti respektojë ligjet e Republikës së Kosovës në lidhje me ngarkimin me funksione shtesë dhe të sigurojë kompensimin e duhur për punën e kryer.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtimes, ndërsa Këshilli më datë 10.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Shtimes me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1302/2025 të datës 27.02.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftim i K.U.; Autorizim nga K.U. për A.R. i datës 03.02.2025; Ankesë e ankueses K.U. drejtuar Komisionit për ankesa në komunën e Shtimes i datës 03.02.2025; Përgjigje në ankesë nga komuna e Shtimes i datës 14.02.2025; Vendim i Kryetarit të Komunës së Shtimes me numër 02Nr.1180 i datës 13.11.2024; Njoftim i datës 19.11.2024; Njoftim i datës 10.01.2025; Autorizim i Kryetarit të Komunës së Shtimes për K.U. me Nr.02/35 i datës 17.01.2025; Ndryshim dhe plotësim i Akt Emërimit i K.U. i datës 11.08.2015; Akt Emërim i K.U. i datës 03.01.2024; Vendim për transfer në pozitën zyrtar kryesor financiar i datës 16.10.2023; Pliko me numër R6645677 i datës 24.02.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 06.03.2025; Përgjigje në ankesë i datës 10.03.2025; Lista e pagave e muajit Janar dhe Shkurt 2025; Lista e pagave e muajit Nëntor dhe Dhjetor 2024;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar** sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesja është e punësuar në pozitën ‘ *Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa* ’ në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Shtimes.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës është konstatuar se me Vendimin me numër 02Nr.1180 të datës 13.11.2024 të nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Shtimes ankuesja është autorizuar të ushtrrojë funksionet e Zyrtarit Kryesor Financiar si funksion shtesë në përputhje me përgjegjësitë e Udhëheqësit të Sektorit të përcaktuar në vendimin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale.

Ankuesja me datë 03.02.2025 ka parashtruar ankesë në Komisionin për ankesa në Komunën e Shtimes kundër vendimit me numër 02Nr.1180 të datës 13.11.2024 të Kryetarit të Komunës së Shtimes. Ndërsa me datë 14.02.2025 Menaxheri i Personelit i Komunës së Shtimes ka nxjerrë përgjigje në ankesë si në vijim citoj: Duke u bazuar në vendimin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Komunës së Shtimes, Nr.02/1172 të datës 29.12.2023 në nenin 13 paragrafi 2, Sektori për buxhet dhe financa udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit, i cili njëkohësisht ushtron funksionet shtesë dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) të përcaktuar me ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike, dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillim e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit të Kryetarit të Komunës së Shtimes me numër 02Nr.1180 të datës 13.11.2024 dhe përgjigjes në ankesë të datës 14.02.2025 të Komunës së Shtimes në lidhje me ngarkimin me funksione shtesë pa kompensim dhe pa bazë ligjore kërkon ti aprovohet ankesa të anulohet vendimi i Kryetarit të Komunës së Shtimes me numër 02Nr.1180 i datës 13.11.2024 dhe të obligohet komuna që ti respektojë

ligjet e Republikës së Kosovës në lidhje me ngarkimin me funksione shtesë dhe të sigurojë kompensimin e duhur për punën e kryer.

Kolegji i Këshilli me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe kërkesave të ankueses, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht nenin 1 dhe 2 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “2. *Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.* 2.1. *Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë.* 2.2. *Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj.*”, ndërlidhur me nenin 45 paragrafi 2 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: “*Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji*”.

Në kuptim të nenit 35 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit analizoi kriteret lidhur me përfitimin e pagesës për funksionin shtesë sikurse rregullohet me dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë ku përcaktohet se: **1. Nëse një zyrtar publik i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, kërkohet që të shërbejë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme ky zyrtar publik nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme e zyrtarit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.** 2.“Përjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. **funkcioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë;** 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar”, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se kjo dispozitë ka përcaktuar kriteret se për tu kompensuar anëtar apo anëtarët e një komisioni në emër të funksioneve shtesë duhet të plotësohen të gjitha parakushtet ligjore së bashku/si tërësi, apo thënë ndryshe në frymën e normës juridike në mënyrë kumulative, ndërsa në rrethanat e rastit konkret dhe meqenëse është kontestuese nga pala në procedurë në lidhje me ngarkimin me funksione shtesë, konstatohet fakti se parakushti ligjor i përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 5 të së njëjtës rregullore nuk është plotësuar, pasi që ankuesja sipas Akt Emërimit konstatohet se është nëpunëse civile në kuadër të Komunës së Shtimes, dhe si rrjedhojë vendimi për funksione shtesë në përputhje me përgjegjësitë e Udhëheqësit të Sektorit të përcaktuar në vendimin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale është nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Shtimes.

Prandaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, nga analizimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë dhe analizimi i dispozitave ligjore dhe akteve që derivojnë nga ligji i pagave të cilat rregullojnë në mënyrë specifike çështjen e kompensimit apo pagesës për funksionin

shtesë, konstatoi se ankesa e ankueses e datës 27.02.2025 është e pabazuar dhe e njëjta është refuzuar, sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.375/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, avokatit Agim Rexhaj;
- Komunës së Shtimes (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.